



QENDRA KOMBETARE E CILESISE,
SIGURISE DHE AKREDITIMIT TE
INSTITUCIONEVE SHENDETSORE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETSISE

“PERMIRESIMI I CILESISE NE INSTITUCIONET SHENDETSORE”.

KONFERENCA E 2-TE KOMBETARE PER
SHERBIMIN SHENDETESOR, DHJETOR 2007

QENDRS KOMBETARE E CILESISE, SIGURISE
DHE AKREDITIMIT TE INSTITUCIONEVE
SHENDETSORE-QK-CSA
ADDRESS: BLV. ZOGU I, SPITALI OBSTETRIK-
GJINEKOLOGJIK “MBRETERESHA
GERALDINE”, TIRANA-ALBANIA
TEL: + 355 4 234 221, FAX: + 355 4 234 225

RAPORT

Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore-QK-CSA, organizoi në Tiranë në 13 Dhjetor 2007 Konferencën e Dytë Kombëtare të Cilësisë me temë “PERMIRËSIMI I CILËSISË NE INSTITUCIONET SHËNDETSORE”. Kjo konferencë ishte me rëndësi për të gjithë politike bërësit, profesionistët shëndetësorë, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, pacientët dhe përfaqësuesit e tyre. QK-CSA, ofroi të gjitha mundësitë dhe përvojën e vet si dhe tregoi hapat e para drejt akreditimit të institucioneve shëndetësore sikundër edhe përvojën e parë për marrjen e pëlqimit të pacientëve para ndërhyrjes sikundër edhe studimin për vrojtimin e kenaqesive së pacientëve me shërbimin.

Organizuesit paraqiten aktivitete të QK-CSA gjatë vitit të dytë të punës së këtij institucioni duke shkëmbyer edhe përvojën me aktorët e ndryshëm që punojnë për përmirësimin e cilësisë në shërbimet shëndetësore në spitale, kujdesin parësor, institutin e sigurimeve shëndetësore, shoqatat profesionale, stomatologët, farmacistët, etj. Në konferencë morën pjesë një numër i konsiderueshëm përfaqësues institucionesh shëndetësore në Shqipëri. Liste plotë pjesëmarrësve paraqitet në Aneksin 1. Është e rëndësishme të vihet në dukje se në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të Qendrës Kombëtare Polake të Cilësisë (National Centre for Quality Assessment in Health Care (NCQA), Poland, Krakow).

Konferenca u përshëndet nga Zv. Ministri i Shëndetësisë Dr. Arben Ivanaj i cili bëri edhe një prezantim të shkurtër mbi strategjinë e përmirësimit të cilësisë sipas Ministrisë së Shëndetësisë.

Aneksi 2 i raportit paraqet në hollësi të gjitha prezantimet e mbajtura nga secili pjesëmarrës në konferencë.

Pjesëmarrja e gjere dhe aktive në konferencë shtroi rrugën e një organizimi të rregullt të këtyre konferencave edhe në të ardhmen nga QK-CSA. Profesor Kalo, Drejtor i Qendrës, krijoi një atmosferë miqësore për të gjithë pjesëmarrësit.

KONKLUZIONE

Në nga arritjet më të rëndësishme të kësaj konferencë ishte përvoja e fituar nga profesionistët shëndetësorë në vet-vlerësimin dhe krahasimin anonim të rezultateve të nivelit të arritur të standardeve në 12 spitale rajonale të Shqipërisë.

Në një zhvillim tjetër, dy spitalet kryesore obstetrikë gjinekologjik të Tiranës bënë jo vetëm krahasimin e rezultateve të arritjes së standardeve në baze të vet-vlerësimit por edhe ju nënshtruan vlerësimit të jashtëm si një hap i parë drejt akreditimit. Përvoja e fituar shërbeu si nxitje edhe për realizimin e vlerësimeve të tjera në spitale të rrethëve kryesore të vendit.

Për here të parë u bë e mundur futja e praktikës në disa spitale për mbushjen e formularëve specifike për marrjen e pëlqimit të pacientëve pra disa ndërhyrje kirurgjikale. Aspekte të tjera të konferencës ishin njohja me procesin e aspekteve ligjore të mjekit dhe konsekuencat e tyre. Po ashtu me rëndësi ishte roli i shoqatës infermiere në levizjen për cilësi si dhe njohja e zërit të pacientëve.

Në të njëjtën kohë, gjatë procesit të vet-vlerësimit të standardeve për here të parë u krye edhe studimi për të parë përshtypjet e pacientëve lidhur me kushtet dhe shërbimin në spitale (shiko prezantimin përkatës).

Ne një zhvillim tjetër, pjesëmarrja e shoqatave të ndryshme profesioniste shtroi rrugën e përpjekjeve për përgatitjen e standardeve për kujdesin parësor, stomatologjinë, farmacinë, laboratorët mjekësore, etj. Ky është subjekt i punës së ardhme të QK-CSA së bashku me këto shoqata gjatë vitit 2008 për prodhimin e standardeve në këto profesione.

QK-CSA ka botuar gjatë vitit 2007 mbi 13 publikime çka bënë të mundur të mësuarit dhe vetmësimin lidhur me konceptet e cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për përhapjen e kulturës së cilësisë në të gjithë profesionet shëndetsore.

Se fundi, QK-CSA nisi punën e organizmit të procesit të miratimit të principeve kryesore për licencimin e individëve dhe institucioneve shëndetësore.

Arritjet kryesore dhe rruga përpara përmbledhen shkurtimisht në prezantimin Prof Kalos (shiko prezantimin e përmbylljes së konferencës).

Konferenca u konsiderua si sukses nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët premtuan për vazhdimin e kësaj pune bashkëpunuese në të ardhmen.